



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2020:179926

Datë: 20.01.2025

Numri i dokumentit: 06728263

**C.nr. 5499/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.K.nga K., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.K., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës K.F., me NUI ....., me seli në Prishtinë, e përfaqësuar sipas autorizimit nga F.P., avokat nga Prishtina, me objekt kontesti: kompensimin e të ardhurave personale, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik i mbajtur në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, ndërsa me datë 20.01.2025 e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.K.nga K..

**II. DETYROHET** e paditura K.F. me seli në Prishtinë, me NUI ....., që paditësit, në emër të pagave neto të papaguara për periudhën 18.12.2017 deri me datë 01.06.2019, t'ia paguaj shumën prej 5,612.51 euro, me kamatë ligjore 8 % nga paraqitja e padisë me datë 18.12.2020 e deri në përmbushjen definitive, si dhe në emër të kontributit pensional që duhet të paguhet në Trustin Pensional në emër të punëmarrësit shumën prej 328.22 euro, në emër të kontributit pensional që duhet të paguhet në Trustin Pensional në emër të punëdhënësit shumën prej 328.22 euro dhe në emër të tatimit në pagë që duhet të paguhet në dobi të Buxhetit të Republikës së Kosovës shumën prej 623.61 euro, e të gjitha këto brenda afatit prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

**III. REFUZOHET** e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit B.K. nga K., me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura K.F. me seli në Prishtinë, me NUI ....., që paditësit në emër të pagave neto të papaguara për periudhën nga data 01.01.2014 deri me datë 17.12.2017 t'ia paguaj shumën prej 2,062.50 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, në emër të kontributit pensional që duhet të paguhet në Trustin Pensional në emër të punëmarrësit shumën prej 120.60 euro, në emër të kontributit pensional që duhet të paguhet në Trustin Pensional në emër të punëdhënësit shumën prej 120.60 euro dhe në emër të tatimit në pagë që duhet të paguhet në dobi të Buxhetit të Republikës së Kosovës shumën prej 229.17 euro.

**IV. DETYROHET** e paditura K.F. me seli në Prishtinë me NUI ....., që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t'ia paguaj shumën prej 864.00 euro, në afat prej

shtatë (7) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësi me datë 18 dhjetor 2020 pranë kësaj gjykate ka paraqitur kundër të paditurës K.F.. Në padi ndër të tjera ka theksuar se, paditësi dhe e paditura kanë themeluar marrëdhënie pune përmes kontratave me afat, ku paditësi si ligjërues i gjuhës angleze ka ligjëruar në dy qendra tek e paditura në Prishtinë dhe në Gjilan. Ka shtuar se, këto kontrata kanë zgjatur deri me datë 30.01.2019, dhe fillimisht paga ka qenë në lartësi prej 450.00 euro ndërsa me vonë është rritur në 600.00 euro. Me tutje, ka theksuar se gjatë kësaj periudhe paditësi ka mbajtur mësim me rregull për të gjitha orët për të cilat ka qenë i angazhuar, ndërsa e paditura nuk i ka kompensuar të gjitha të ardhurat personale për periudhën sikurse me lartë. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka qëndruar në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj të precizuar, dhe nga gjykata ka kërkuar të aprovohet në tërësi e bazuar kërkesëpapia e paditësit B.K., të detyrohet K.F. me seli në Prishtinë që paditësit borxhin e pagave t'i paguajë për periudhën nga data 01.01.2014 deri me 01.06.2019 në emër të pagës neto 7,675.00 euro, në emër të kontributit pensional të punëdhënësit shumë prej 448.83 euro, në emër të kontributit pensional të punësuarit shumë prej 448.83 euro, si dhe shumë prej 852.78 euro në emër të tatimit në pagë së bashku me kamatë ligjore prej 8% nga momenti i paraqitjes së padisë e deri në përmbushjen e tërësishme, e gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 160.00 euro, për taksën gjyqësore shumë prej 20.00 euro, në emër të ekspertizës financiare shumë prej 200.00 euro, dhe për pesë seanca për secilën nga 135.00 euro, e në shumë e përgjithshme prej 1,190.00 euro.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në padi, ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesën e saj. Ka shtuar se padia është e parakohshme dhe bie në kundërshtim me nenin 79 të Ligjit të Punës, sepse nga shkresat nuk rezulton që paditësi të ketë shterur paraprakisht mjetet interne nga neni 78 i Ligjit të Punës nga ku rezulton se padia lëndore marrë parasysh rrethanat në të cilën gjendet procedura është e pa lejuar çka mbështetet edhe nga praktika e kësaj gjykate, e që në rastet e ngjashme ka hedhur si të pa lejuar paditë e paraqitura pa shterjen paraprake të mjeteve interne. Ka theksuar se, nga referati i padisë rezulton që paditësi kërkon kompensimin e pagave për periudhën kohore 2014-2020 edhe pse kontrata e fundit e punës të paktën nga ajo që shihet në padi është e vitit 2018, me këtë rast parashtrijmë se konform nenit 87 të Ligjit të Punës kërkesat në të holla të mataruara deri me datë 18.12.2017, janë parashkruar. Me tutje ka shtuar se, me ekspertizë është provuar se paditësi ka pasur dy marrëdhënie të rregullta të punës të njëkohësishme, nga të cilat ka realizuar të hyra e të cilat nuk parashikohen me asnjë dispozitë të Ligjit të Punës, përkundrazi me nenin 19 të Kontratës së Punës numër ....e datës 07.12.2017, dhe me kontratën e punës numër .... e datës 24.10.2018 të cilat janë administruar gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor në cilësinë e provave materiale neni 19 i kontratave në fjalë parashikon

shprehimisht “nënshkrimi i një kontrate të re pune me orar të plotë, me çdo subjekt tjetër publik apo privat gjatë kohës së vlefshmërisë së kësaj kontrate nënkupton ndërprerje vullnetare dhe të njëanshme të marrëdhënies së punës nga i punësuari, në kuptim të nenit 69.1 të Ligjit të Punës duke shfuqizuar rrjedhimisht vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e të gjitha dispozitave të kësaj kontrate”, klauzolë e cila gjendet në dy kontratat e lartpërmendura e për të cilat paditësi është pajtuar. Me tutje ka theksuar se, në regjistrin e ARBK- së nuk figuron asnjë subjekt juridik me emërtimin “K.F.”, dhe një numër i tillë referues NUI nuk është precizuar as në padi, çka vë në pikëpyetje legjitimitetin procedural pasiv të të paditurës, dhe për këto arsye nga gjykata ka kërkuar që të hudhë si të palejuar padinë apo që të njëjtën të refuzojë si të pathemeltë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, bazuar në propozimet e palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit, dhe në këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat: Kontrata e punës me numër ....e datës 30.10.2014, Aneksi i kontratës me numër ....e datës 23.12.2014, Kontrata e punës me numër ....e datës 01.06.2017, Kontrata e punës me numër ....e datës 01.06.2017, Vërtetimi me numër 191/0215 i datës 02.03.2015, Konfirmimi numër 07/0918 i datës 18.09.2018, Kontrata me numër ....e datës 07.12.2017, Kontrata e datës 24.10.2018 me numër .... dhe Ekspertiza financiare e datës 08.07.2024.

Gjykata, pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në nenin 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim si: LPK), erdhi në përfundimin se padia e paditësit është pjesërisht e bazuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi me të paditurën kanë themeluar marrëdhënie pune, fillimisht për vitin akademik 2014 – 2015, e më pastaj edhe për periudhën 01.06.2017 deri me 04.06.2019. Ky fakt vërtetohet edhe nga kontratat e punës të lidhura në mes të paditësit dhe të paditurës, kontrata e punës me numër ....e datës 30.10.2014, kontrata e punës me numër .... e datës 01.06.2017, kontrata me numër ....e datës 07.12.2017 dhe kontrata e datës 24.10.2018 me numër .... Po ashtu, nuk ishte kontestuese se paditësi, gjatë periudhës kontestuese i ka përmbushur obligimet kontraktuale sipas kontratave dhe njëkohësisht nuk ishte kontestuese lartësia e kërkesës së paditësit.

Kontestuese për të paditurën ishte lejueshmëria e padisë, përkatësisht nëse e njëjta lejohet të paraqitet në mungesë të shfrytëzimit të mjeteve të brendshme tek punëdhënësi, po ashtu, kontestuese ishte edhe nëse kërkesa e paditësit është parashkruar, e po ashtu nëse paditësi kishte të drejtë të themelonte dy marrëdhënie pune në të njëjtën kohë. Njëkohësisht, sipas të paditurës kontestues ishte edhe legjitimiteti i saj, sepse sipas saj në regjistrin e ARBK- së nuk figuron asnjë subjekt juridik me emërtimin “K.F.”.

Nga kontrata e punës me numër të protokollit .... e datës 30.10.2014, e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se për periudhën kontestuese 15.10.2014 deri me datë 15.05.2015, paditësi me të paditurin kishin themeluar marrëdhënie pune me kohë të caktuar, ku paditësi do të mbante pozitën e ligjëruesit. Sipas kësaj kontrate të punës, palët kontraktuese ishin dakorduar që paga mujore e paditësit të ishte 450.00 euro, dhe pagesa do të bëhej në llogarinë

bankare të paditësit.

Nga kontrata e punës me numër të protokollit .... e datës 01.06.2017, e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se për periudhën kontestuese 01.06.2017 deri me datë 01.06.2019, paditësi me të paditurin kishin themeluar marrëdhënie pune me kohë të caktuar, ku paditësi do të mbante pozitën e ligjëruesit. Sipas kësaj kontrate të punës, palët kontraktuese ishin dakorduar që paga mujore e paditësit do të ishte 750.00 euro.

Nga të njëjtat kontrata, konstatohet se janë lidhur në mes të paditësit B.K. në njërën anë në cilësi të punëmarrësit, dhe të paditurës K.F. me numër të biznesit 70041962 i përfaqësuar nga S.A. në anën tjetër në cilësi të punëdhënësit.

Me propozimin e paditësit, gjykata ka bërë nxjerrjen e provës përmes ekspertizës financiare. Ekspertja në ekspertizën financiare, ka bërë kalkulimin e pagave të pa paguara për periudhën kontestuese 2014 - 2020 duke u mbështetur në: kontratën e punës me nr.....të datës 30.10.2014, aneks kontratën me nr. ....të datës 23.12.2014, kontratën me nr.....e datës 01.06.2017, kontratën me nr.....e datës 07.12.2017 dhe kontratën me nr..... të datës 24.10.2018, ku shihet se paga mujore fillimisht 450.00€ neto, pastaj 600.00€ dhe në fund 750.00€ neto. Po ashtu, ekspertja financiare ka marrë për bazë pagat e kontraktuara tek e paditura e të cilat është dashur t'i realizonte paditësi dhe pagat e realizuara gjatë periudhës kontestuese të cilat i ka konstatuar në bazë të kontributeve të tyre të paguara në Trustin e Kursimeve Pensionale nga e paditura dhe në bazë të raporteve bankare përmes të cilave llogari i janë paguar pagat paditësit, ashtu që në këtë rast për paditësin ka llogaritur pagat e paguara, diferencën për pagat të cilat nuk janë paguar sipas shumave të kontraktuara me kontratat e punës, si dhe shumën e pagave që paditësit nuk i janë paguar fare në llogarinë e tij bankare. Tutje nga ekspertiza financiare, konstatohet se nga e paditura janë paguar disa paga nga viti 2014 deri në vitin 2020, të cilat janë paraqitur në këtë ekspertizë, dhe pas llogaritjes së të hyrave në bankë janë bërë diferencat e pagës bruto sipas kontratave të punës dhe pagës bruto sipas raportit të bankës dhe shumat e papaguara janë paraqitur në ekspertizën financiare.

Ekspertja ka konstatuar se pagat e pa paguara të paditësit duke u bazuar në kontratat e nënshkruara gjatë periudhës 01.01.2014 deri me datë 01.06.2019 janë si në vijim: paga bruto në shumën prej 8,976.62 euro, paga neto në shumën prej 7,675.01 euro, kontributi pensional në emër të punësuarit në shumën prej 448.83 euro, kontributi pensional në emër të punëdhënësit në shumën prej 448.83 euro, tatimi në pagë në shumën prej 852.78 euro. Në të njëjtën kohë, në ekspertizë financiare pagat e pa paguara janë pasqyruar në dy periudha kohore, dhe atë nga data 01.01.2014 deri me datën 18.12.2017 dhe në periudhën kohore nga data 18.12.2017 deri me datën 01.06.2019. Sipas kësaj ekspertize, pagat e pa paguara të paditësit në periudhën prej datës 01.01.2014 deri me datën 18.12.2017 janë: në emër të pagës neto shuma prej 2,062.50 euro, në emër të kontributit pensional që duhet të paguhet në Trustin Pensional në emër të paditësit shumën prej 120.60 euro, në emër të kontributit pensional që duhet të paguhet në Trustin Pensional në emër të punëdhënësit shumën prej 120.60 euro, dhe në emër të tatimit në pagë që duhet të paguhet në dobi të Buxhetit të Republikës së Kosovës shumën prej 229.17 euro. Kurse, për periudhën 18.12.2017 deri me datë 01.06.2019, ekspertiza ka konstatuar se shuma në emër

të pagave neto të papaguara është në lartësi 5,612.51 euro, në emër të kontributit pensional që duhet të paguhet në Trustin Pensional në emër të paditësit shuma prej 328.22 euro, në emër të kontributit pensional që duhet të paguhet në Trustin Pensional në emër të punëdhënësit shuma prej 328.22 euro, në emër të tatimit në pagë që duhet të paguhet në dobi të Buxhetit të Republikës së Kosovës shumën prej 623.61 euro. Gjykata ekspertizën financiare e ka vlerësuar si profesionale dhe të argumentuar mirë dhe të njëjtën e ka pranuar në tërësi si të besueshme, pasi që e njëjta është hartuar konform detyrave të përcaktuara me aktvendimin e gjykatës. Po ashtu, ekspertja ka marr pjesë në seancën e shqyrtimit kryesor për të dhënë sqarimet e nevojshme, mirëpo në këtë seancë të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse kanë deklaruar se nuk kanë vërejtje për ekspertizën, e as pyetje për ekspertin prezentë.

Nga vërtetimi i gjendjes faktike si më lartë, gjykata vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohet dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës dhe dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Me nenin 55 paragraf 1, të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës është paraparë se: “ *I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit*”. Ndërsa, me nenin 87 të Ligjit të punës parashihet se: *Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.*

Sipas nenit 245 par. 1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim si: LMD) parashihet se “*kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsadebitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij*”. Kurse me nenin 356, paragrafi 1 të LMD-së, parashihet: *1. Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike akcesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë.*

Në bazë të provave të vlerësuara dhe administruara, gjykata konstaton se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, kjo për faktin se është vërtetuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe i njëjti nuk i ka përmbushur në tërësi obligimet e kontratave në raport me pagesën e pagave, kontributit pensional dhe tatimit në pagë, për periudhën kontestuese edhe pse i njëjti në bazë të kontratës së punës dhe Ligjit të Punës kishte për obligim që të bëjë një gjë të tillë. Pra, nga provat e administruara, përkatësisht ekspertiza financiare është vërtetuar se e paditura për periudhën kontestuese i ka ngelur borxh paditësit për pagat e papaguara, diferencës në pagë, kontribut pensional dhe tatimit në këtë diferencë, e cila saktësisht është përcaktuar në ekspertizën që është përshkruar me lartë.

Prandaj, në këtë rast ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raport i detyrimeve në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit, ndërsa e paditura cilësinë e debitorit. Meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se e paditura gjatë periudhës kontestuese i ka mbetur borxh paditësit për shkak se nuk ia ka paguar në tërësi pagat siç ka qenë e përcaktuar me kontratën e punës,

gjykata me aplikimin e dispozitave ligjore të cekura me sipër dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në të njëjtën kohë, gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës, përkatësisht pretendimin lidhur me atë se paditësi nuk i ka shfrytëzuar paraprakisht mjetet e brendshme të paditura, ashtu siç parashihet me nenin 79 të Ligjit të Punës, mirëpo gjykata vlerëson se një pretendim i tillë nuk qëndron, për faktin se dispozita e lartcekur nuk gjë në zbatim në rastet kur kërkesat janë të drejtuara në aspektin monetar, sikurse në rastin konkret kërkesat e paditësit.

Ndërsa, në raport me pretendimin tjetër të paditurës lidhur me atë se paditësi ka pasur dy marrëdhënie të rregullta të punës të njëkohësishme, nga të cilat ka realizuar të hyra e të cilat nuk parashikohen me asnjë dispozitë të Ligjit të Punës, e në kundërshtim me kontratën e punës me numër ....e datës 07.12.2017, dhe me kontratën e punës numër .... e datës 24.10.2018, gjykata vlerësoj se një pretendim i tillë është i pa qëndrueshëm. Kjo për faktin se, në kontestin përkatës mes të paditësit dhe të paditurës, gjykata kufizohet në vlerësimin nëse paditësi ka punuar tek e paditura sipas kontratës së punës dhe nëse i njëjti është paguar për punën e kryer, ndërsa sipas vlerësimit të gjykatës përderisa është provuar që paditësi gjatë periudhës kontestuese si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi i ka përmbushur në tërësi kontratat dhe për këtë e paditura nuk ka paraqitur vërejtje, atëherë rrjedhimisht e paditura ka për obligim pagesën e detyrimeve – pagave për punën e kryer nga paditësi. Në anën tjetër, në këtë çështje juridike kontestimore nuk është paraqitur si kërkesë anulimi i kontratës së punës së paditësit, andaj gjykata nuk mund të lëshohet në vlerësimin nëse themelimi i dy marrëdhënie të njëkohshme të punës është i ligjshëm ose jo, por përderisa e paditura ka nënshkruar kontratë të punës me paditësin dhe përderisa është provuar që paditësi për periudhën kontestuese ka kryer punë tek e paditura, e paditura ka për obligim pagesën e detyrimeve – pagave ndaj paditësit.

Për më shumë, gjykata vlerëson se në kontestet nga marrëdhënia e punës, kur objekt i kontestit janë pagat e papaguara, barra e të provuarit të faktit se a është përmbushur kontrata, apo nëse janë paguar pagat bie mbi vetë të paditurën, e cila në marrëdhënien e themeluar të punës e kishte cilësinë e punëdhënësit, dhe rrjedhimisht në rrethana të tilla të kontestit të gjykuar me këtë aktgjykim, e paditura do të duhej të argumentonte se paditësi nuk e ka përmbushur kontratën ashtu siç palët janë pajtuar paraprakisht. Gjykata po ashtu sjell në vëmendje se palët kanë për obligim që në procedurë civile të paraqesin prova për të provuar pretendimet e tyre të paraqitura gjatë zhvillimit të procedurës, kjo duke u bazuar në nenin 7 paragraf 1 të LPK-së ku është paraparë se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”* Ndërsa neni 319.1, i të njëjtit ligj thekson se *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.”*

E paditura po ashtu ka pretenduar se në regjistrin e ARBK - së nuk figuron asnjë subjekt juridik me emërtimin “K.F.”, duke e kontestuar legjitimitetin procedural pasiv të të paditurës, por i njëjti pretendim sipas vlerësimit të gjykatës po ashtu është i pabazuar. Kjo për faktin se, nga kontratat e lidhura në mes të paditësit dhe të paditurës konstatohet se kontratat e punës janë lidhur me të paditurën me emrin “K.F.”, dhe se e paditura e ka cilësinë e biznesit individual, dhe në të njëjtat

është i shënuar numri i biznesit 70041962. Duke qenë se gjykata lidhur me cilësinë e palëve në procedurë sipas nenit 76 të LPK-së kujdeset sipas detyrës zyrtare, nga i njëjti numër i biznesit, në regjistrat publik të ARBK-së konstatohet se e njëjta është e regjistruar me emrin tregtar “U.F.” me NUI ..., dhe ka statusin e “regjistruar”, dhe në rastin konkret vendimtare është numri unik identifikues, sepse i njëjti nuk mund të ndryshohet përdërisa emërtimi tregtar mund të ndryshoj, andaj rrjedhimisht konstatohet se kemi të bëjmë me të njëjtin subjekt. Tutje, Gjykata vlerëson se e paditura duke qenë e regjistruar si biznes individual, pronari i të njëjtës mban përgjegjësi për të gjitha detyrimet e biznesit individual ndaj palëve të treta, andaj është në situatën eventuale kur biznesi individual do të pushonte së ekzistuari, pronari i biznesit individual përgjigjet për të gjitha detyrimet ndaj palëve të treta me pasurinë e tij personale.

Sa i përket pikës III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata gjen se paditësi shumat e pagave të papaguara dhe kontributeve të tjera, i ka kërkuar sipas padisë dhe precizimit të saj, për periudhën nga data 01.01.2014 deri me datë 01.06.2019. Në këtë kuptim, përfaqësuesi i të paditurës në seancën e shqyrtimit gjyqësor, si pretendim kryesor ka paraqitur faktin se kërkesa e paditësit është e përfshirë në parashkrim. Gjykata duke vlerësuar pretendimet e përfaqësuesit të paditurës për parashkrim të kërkesës, e duke marr për bazë faktin se padia në gjykatë është paraqitur me datë 18.12.2020, gjen se ky pretendim është pjesërisht i bazuar, dhe se kërkesa e paditësit për periudhën nga data 01.01.2014 deri me datë 17.12.2017, janë të parashkruara, kjo për faktin se nga dita kur secila kërkesë për pagesën e pagës të muajit përkatës për këtë periudhë kontestuese është bërë e arritshme, ka kaluar afati prej tre viteve sipas nenit 87 të Ligjit të Punës për secilën nga kërkesat për pagesën e pagave, për periudhën 01.01.2014 deri me 18.12.2017, dhe rrjedhimisht për këtë periudhë, kërkesat e paditësit janë parashkruar, dhe paditësi nuk mund të kërkojë në procedurë gjyqësore realizimin e pagave – të ardhurave personale për periudhën e parashkruar.

Vendimin mbi kamatën gjykata e bazoj në nenin 382 të LMD-së, sipas të cilit: *“1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, dhe atë nga momenti i paraqitjes së padisë me datë 18.12.2020, duke u bazuar në propozimin e palës paditëse.

Gjykata vendosi që e paditura të obligohet për pagimin e shpenzimeve të procedurës, duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së, i cili përcakton: *452.1 Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore*. Ndërsa, lartësinë e shpenzimeve të procedurës gjykata e bazoj në Tarifën e Odës së Avokatëve, dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro, për pjesëmarrje në katër seanca gjyqësore shumë prej 135.00 euro për secilën seancë e në shumë e përgjithshme për seanca 540.00 euro, për ekspertizën financiare shumë prej 200.00 euro, dhe për taksë gjyqësore shumë prej 20.00 euro, e në shumë e përgjithshme në emër të shpenzimeve të procedurës prej 864.00 euro. Ndërsa, gjykata nuk i njohu shpenzimet e tjera të kërkuara nga i autorizuari i paditësit edhe për dy seanca të tjera, për faktin se të njëjtat nuk ishin mbajtur pa fajin e të paditurës.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, e në përputhje me nenin 160 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.5499/2020, datë 20.01.2025**

Gjyqtari  
Argzon Muçaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.